

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 26330/26

Nr. i fq. / Br. st. -5-

Data: / Datum: 23.06.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 103/26, 23.06.2026

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26 maj 2026
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Xhon Gubetini, Kushtrim Hyseni, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se na ka ardhur dy propozime për t'i shtuar në rend të ditës:

- Propozim – vendim për dhënien e titullit “Emblema e Vushtrrisë”;
- Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i qytetit”.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – i kam dy propozime për t'i futur në rend të ditës si pika të veçanta. Propozimi i parë ka të bëjë lidhur me atë që e kam propozuar dy mbledhje më herët – mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta. Konkretisht, fëmijët që janë të diagnostifikuar me sindromën down dhe autizëm. Tashmë veç i posedoj statistikën që i kam marrë në Drejtorinë për Arsim për fëmijët me sindromën down dhe autizëm që janë me diagnozë. Janë 13 fëmijë me autizëm dhe 3 me sindromën down. Ndoshta mund të ketë edhe fëmijë tjerë që nuk janë regjistruar, por ky numër është zyrtar nga drejtoria. Propozoj që këtyre fëmijëve t'ju ndahen çdo muaj nga 100 euro, nga kategoria “subvencione dhe transfere”. E di që një mbështetje të vogël për transport ua jep Drejtoria e Shëndetësisë, për vijimin e mësimin në shkolla speciale. Por, kjo është një ndihmë tjetër që sado pak t'ua lehtësojmë prindërve të tyre.

Propozimi tjetër është që të futet në rend të ditës ndarja e mirënjohjeve.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – sa i përket propozimit të parë u pa që i ke informatat vetëm nga Drejtoria e Arsimit, jo edhe nga Drejtoria për Shëndetësi.

Kurse, sa i përket mirënjohjeve dhe dekoratave, sipas rregullores mundeni secili me i bërë 72 orë para seancës ose për mirënjohje drejtpërdrejt në kuvend.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – lidhur me statistikat nga Drejtoria për Shëndetësi, ata më kanë thënë që nuk i kemi.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se sipas një analize financiare që e kam bërë në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, në bazë të planifikimit të buxhetit që e kemi për vitin 2026, ku në këtë kategori ka qenë 2,500,000.00€. Kurse, nga kjo shumë deri më tani janë shpenzuar 2,112,134.00€. Kemi obligime shumë të mëdha këtë vit për shkak të vendimeve përmbarimore. Po ashtu, janë marrë shumë vendime në këtë kuvend që ende nuk janë paguar, në mungesë të mjeteve financiare.

Kategoria e fëmijëve me nevoja të veçanta është e ndjeshme dhe të gjithë e përkrahim. Nëse merret vendim, pastaj po kemi telashe, sepse mjete financiare nuk ka, kurse palët vijnë dhe i kërkojnë mjetet financiare. Kështu që, qarkoren buxhetore e kemi në rend të ditës dhe do ta parashohim me plan buxhetor të vitit 2027 si kategori të veçantë. Çdo hap që merret pa planifikim të mjeteve financiare, MAPL me Ministrinë e Financave do i kthejnë si të paligjshme.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – drejtor, nuk mund të më bindësh që nuk ka buxhet, ku brenda dy muajve i keni pasur së paku pesë vizita jashtë vendit. Shuma financiare për përkrahjen e këtyre fëmijëve brenda një viti është 19,200.00€. Unë nuk do të heqi dorë nga ky propozim, do propozoj edhe në kuvend. Ne mund të marrim vendim që të fillojë pagesa nga janari i vitit 2027.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – unë jam konfuze edhe për disa gjëra. Sipas disa statistikave, 140 fëmijë kërkojnë asistencë në shkolla. Po kërkoj nga ekzekutivi, decidivisht nga Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Shëndetësi, që deri në momentin kur do ta diskutojmë draft-buxhetin për vitin e ardhshëm, të na japin shifrat e sakta, të paktën për fëmijët që janë të regjistruar në shkolla e çerdhe, edhe për fëmijët tjerët që Drejtoria e Shëndetësisë duhet të kenë informata, në mënyrë që ta kompletojmë numrin e saktë të këtyre fëmijëve, që të bëhet planifikimi i buxhetit për përkrahje financiare për këta fëmijë. Pra, unë personalisht mendoj që duhet të përkrahen të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – theksoi se zyrtarët që kanë shkuar në trajnime janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe nuk është kategori e subvencioneve. Ai tha se fëmijëve me nevoja të veçanta ju kemi ndihmuar me vendime të veçanta dhe prapë do t'iu ndihmojnë. Por, për ta futur si kategori të veçantë për ta përkrahur, këtë vit nuk ka mundësi.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – vet fakti që jemi dy ditë para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, ju si qeverisje lokale na i sillni dy propozime që janë shumë të rëndësishme, tregon për joseriozitetin që e keni ju ndaj ditës së çlirimit të komunës sonë. Neve si anëtarë të KPF-së dhe të subjekteve politike po na vendosni para aktit të kryer. Ju i keni votat edhe në KPF e Kuvend, sepse e shfrytëzoni arrogancën e numrave. Por, ne e kemi obligim para qytetarëve dhe para partive tona politike ta kemi një informim më të hershëm për këtë çështje.

Propozimi im është që titulli “Nderi i qytetit”, titulli “Emblema e Vushtrrisë” dhe propozimin që e dha Fatmirja ta shtyjme për ditën e enjte, ose të mbahet mbledhje e re e KPF-së në ora 8:00 ose 9:00, sepse na duhen konsultime edhe me qytetarë, por edhe me partitë tona politike që ne i përfaqësojmë këtu. Pra, unë jam i pa përgatitur, sepse nuk e kam pasur më herët një material të tillë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – duhet të dallohen kompetencat e kuvendit me të ekzekutivit. E dimë që këto propozime i bënë kryetari i komunës, i cili propozimet i ka marrë nga komisioni. Kurse, ne si KPF e kuvend jemi ata që vendosim. Është e vërtetë që i kemi votat, por dikush i ka edhe 51% e s'po i dalin.

Blerina Shala, anëtare e KPF-së – dua të ndërlidhem te propozimi i Fatmirës, sepse përballem vet me një situatë të tillë. Konsideroj se statistikat janë gabim, sepse këta fëmijë që përkrahen nga ministria janë shumë më shumë. Nuk e di numrin e saktë, por e di që është më shumë se këto statistika që i prezantoi Fatmirja. Fëmijët me autizëm dhe fëmijët me ngecje në zhvillim i kanë pothuajse problemet e njëjta. Propozimi im është që të përkrahen të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta. Por, nuk është në rregull të merret një vendim e mos të zbatohet, sepse është kategori e ndjeshme e mos t'i lëndojmë. Qëllimi është që të merret një vendim e të zbatohet për këtë kategori.

Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për”, dy (2) “kundër vendosi që të shtohet në rend të ditës “Propozim – vendim për dhënien e titullit “Emblema e Vushtrrisë”.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “kundër vendosi që të shtohet në rend të ditës “Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i qytetit”.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – lidhur me propozimin për fëmijët me nevoja të veçanta unë dhe Blerina po mendojmë që të kompletohet lënda dhe që të parashikohet me buxhetin e vitit 2027, e të përkrahen të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta, e jo vetëm me sindromën down e autizëm.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kërkoj që të hidhet në votim propozimi im që të përkrahen financiarisht fëmijët me sindromën down dhe autizëm.

Komiteti për Politikë dhe Financa me dy (2) vota “për”, pesë (5) “kundër vendosi që të mos shtohet në rend të ditës “Propozimi që të përkrahen financiarisht fëmijët me sindromën down dhe autizëm.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – po konstatoj se nuk jemi kundër këtyre kategorive, por jemi që të hyn në rend të ditës ashtu siç diskutuam më herët që të planifikohet buxheti paraprakisht.

Sa i përket pikës tjetër që u propozua për të hyrë në rend të ditës “mirënjohje dhe dekorata”, po besoj që në kuvend do ta kemi, si dhe sipas rregullores mund të bëjnë propozime edhe në kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa me dy (2) vota “për”, pesë (5) “kundër vendosi që të mos shtohet në rend të ditës “Mirënjohje dhe dekorata”.

Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për”, dy (2) “kundër aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28.04.2026;
2. Propozim – vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026;
3. Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore për vitin 2027 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike;
4. Propozim – vendim për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
5. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën mars – gusht 2025 dhe periudhën janar – shkurt 2026;
6. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Emblema e Vushtrisë”;
7. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i qytetit”.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28.04.2026.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 28.04.2026.

2. Propozim – vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore për vitin 2027 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se Qarkorja buxhetore 01/2027 ka ardhur me kohë. Buxheti për vitin 2027 është 31,683,485.00€. Ka një rritje të vogël krahasuar me vitin e kaluar. E kemi obligim që në bashkëpunim me kryesuesen dhe Komitetin për Politikë dhe Financa t’i formojmë grupet punuese për dëgjimet buxhetore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Propozim – vendim për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për periudhën mars – gusht 2025 dhe periudhën janar – shkurt 2026.

Isë Hajrizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – deklaroi se këtij raporti i janë shtuar edhe dy familje (që materialin ua sjellëm më herët), për shkak se vlerësimi është bërë tash vonë. Një familje në Shallc dhe një në Dumnicë, është fjala për dëme në bujqësi. Te tabela nr. 3 është bërë një gabim teknik, ku është shkruar “vlerësimi i dëmeve në bujqësi”, a duhet të jetë “vlerësimi i dëmeve në biznese”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Emblema e Vushtrisë”.

Ky çmim është propozuar t’i ndahet Januz Halilit për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Propozim – vendim për dhënien e titullit “Nderi i qytetit”.

Ky çmim është propozuar t’i ndahet Nesim Ispahiut për kontributin e dhënë për qytetin e Vushtrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën **11:50**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës



Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe KPF- së